

5.02.2022

Ora 14:07

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 2,
dt.5.02.2022, subjekti ankues Partia Demokratike”.

PJESËMARRJA :

- KAS:
- Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, po zhvillojmë seancën për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 2, datë 5.02.2022, me ankues Partia Demokratike me objekt “Shfuqizimi i vendimit nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” (Sh-L), për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”. Procedura e shortit do të zhvillohet sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it. Kemi përgatitur pesë shirita letre të bardhë, në një të një prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 2. Shiritat palosen dhe vendosen në pesë gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë, e më pas vendosen në një enë transparente. Një përfaqësues i KQZ-së do t’i tregojë e palosë para kamerave të katër shiritat e bardhë dhe shiritin ku është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 2. Duke qenë se seanca e shortit zhvillohet pa praninë e anëtarëve të KAS-it, kanë autorizuar administratën e KQZ-së që të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre goglat për të caktuar relatorin e Kërkesës Ankimore nr.2. Fillojmë sipas rendit alfabetik rritës, duke filluar nga zoti Elvin Lako.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.02.2022*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilir Rusmali – shiriti del i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Kërkesa Ankimore nr.2. Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit, relator i Kërkesës Ankimore nr. 2, dt.5.02.2022 me ankues Partia Demokratike, dhe objekt “Shfuqizimi i vendimit nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, është zoti Ledio Braho, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

